



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:128429  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05642733  
C.nr.388/20

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretarën juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të paditësit I. K. nga Kaçaniku, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat F. G. nga Prishtina, kundër të paditurës K. K. -D. K. A. , për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë, jashtë seancës gjyqësore me datën 30.04.2024 dhe në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T V E N D I M**

I. Padia e paditësit I. K. nga Kaçaniku, e ushtruar më datën 06.10.2020, kundër të paditurës K. K. -D. K. A. , për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë, pranohet e **TËRHEQUR**.

II. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

III. Gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar taksën në shumë prej 20.00€, ndërsa sa i perkat shpenzimeve tjera secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit më datën 06.10.2020, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, ka ushtruar padi kundër të paditurës K. K. -D. K. A. , për çështjen kontestuese pagesa e shujtës dhe pagave jubilarë. Po ashtu me këtë padi e ka kërkuar që shumat e pranuar nga gjykata të paguhen me kamatë prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuari i paditësit , në Gjykatë e ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka njoftuar gjykatën se e bënë tërheqjen e padisë, sepse me të paditurën e kanë zgjidhur qeshjen me marrëveshje në procedurë jashtë gjyqësorë.

Gjykata padinë e paditësit e konsideroj të tërhequr, sepse paditësit përmes të autorizuarit me parashtresën e ka njoftuar gjykatën se e kanë tërhequr e padisë, sepse me të paditurën qeshjen e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore.

Me dispozitën e nenit 261. 2 të LPK-së, është e paraparë se pala paditëse mund ta tërheq padinë edhe ma vonë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor , në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë, e në rastin konkret e paditura e ka dhënë pëlqimin me rastin e bërjes së pagesës.

Gjykata aktvendimin e ka nxjerr duke u bazuar në nenit 261 par.3 të LPK-së, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa sepse me dispozitën e nenit 261.4 të LPK-së është paraparë se kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi që secila palë ti përballon shpenzimet e krijuar duke e pasur për bazë rezultatin e procedurës.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

C.nr.388/20 prej datës 30.04.2024

Gjyqtari  
Riza LIVOREKA

Dërguar me datën 30.04.2024